

LIGJ
Nr. 16/2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 480, DATË 17.11.2011 “PËR
SIGURINË E PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
“2. Përveçse kur parashikohet drejtpërdrejt nga ligji, strukturat përgjegjëse për kryerjen e funksioneve të mbikëqyrjes së tregut sipas produkteve apo grup produkteve, miratohen apo përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”
2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:
“3. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut i ushtron përgjegjësitë e veta në zbatim të këtij ligji, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj.
4. Procedurat standarde operacionale të veprimtarisë së mbikëqyrjes së tregut, të detyrueshme për të gjitha strukturat e mbikëqyrjes së tregut, miratohen me urdhër të ministrit.”

Neni 2

Në nenin 11, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Krahas masave të parashikuara në këtë nen dhe në nenin 10 të këtij ligji, struktura përgjegjëse merr çdo masë tjetër urgjente të nevojshme, në përputhje me ligjin për inspektimin.”

Neni 3

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Vendime për riskun serioz

Këshilli i Ministrave nxjerr vendime për ndalimin e tregimit, importit ose/dhe eksportit për ato produkte që paraqesin risk të lartë e serioz për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, në rastet kur ka evidenca shkencore ose/dhe faktike për natyrën serioze të riskut, që kërkon ndërhyrje të menjëhershme në nivel kombëtar të mënjanimimit të tij.”

Neni 4

Në nenin 25, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Gjoha është dënim kryesor dhe ajo mund të shoqërohet edhe me një apo disa dënime plotësuese, të përcaktuara në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji.”

Neni 5

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Shqyrtimi i shkeljeve

Shkeljet me karakter administrativ shqyrtohen dhe dënohen nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në përputhje me dispozitat në fuqi.”.

Neni 6

Nenet 27 dhe 31 shfuqizohen.

Neni 7

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28

Ankimi

Ndaj vendimit të strukturës përgjegjëse për marrjen e masave të parashikuara në nenet 20 dhe 21, si dhe për marrjen e masave të tjera urgjente mund të bëhet ankimi i veçantë, sipas ligjit për inspektimin.

Kundër vendimit të strukturës përgjegjëse për dënimin kryesor me gjobë dhe dënimeve plotësuese, mund të bëhet ankimi në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 8

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Ekzekutimi i vendimit të strukturës përgjegjëse

Ekzekutimi i vendimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 9

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miruar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7975, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani